



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 332, datë 17.09.2020

PËR
VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z.{...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E LARTË, PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS
ADMINISTRATIVE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 84, DATË 26.02.2020 DHE
NR. 245, DATË 09.07.2020 DHE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË
DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.87, DATË 26.02.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË
VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”, si dhe nr. 87, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z.Illir Toska,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR